



Islami: një traditë progresiste

Description

Hamza Jusuf

Kur një luftëtar i rezistencës uellsiane, i zënë rob u soll përpara perandorit në Romë tha: “Dëshira jote për të pushtuar botën nuk do të thotëmedoemos se bota dëshiron të pushtohet nga ty.” Sot, po këto fjalë, mund t’ua ofrojmë liberalëve perëndimorë: Dëshira juaj që vlerat tuaja tësundojnë kudo në botë, nuk do të thotë medoemos se bota dëshiron t’i përvetësojë ato.” Zëri kolonizator bazohet nëinjurancën lidhur me traditat epasura të qytetërimeve të tjera dhe në një optimizëm krejt të pavend mbiatë që perëndimi është duke bërë me botën politikisht, ekonomikisht dheambientalisht.

Besimet e rrënjësura që shumë perëndimorë i shfaqin haptazi lidhur me Islamin, shpesh nxjerrin në pah më shumë lidhur me perëndimin sesa lidhurme Islamin dhe muslimanët. Otomanët ishin dinastia që ka zgjatur më shumë në histori; kohëzgjatja e tyre diç duhet të ketë pasur të bëjë me aftësinëe tyre për të sunduar një perëndori shumë-fetarëshe, nw tw njwjtwn kohw, teksa Evropa ndante, përcaktonte e përkufizonte llojet e besimtarëve tëkrishterë.

Sot thuhet se Islami është më pak, jo më shumë tolerant se perëndimi, dhe neve na duhet të pyesim se cilat më saktësisht janë vlerat “perëndimore”me të cilat Islami është kaq i papajtueshëm? Disa besojnë se qëndrimi i Islamit ndaj gruas është burimi i problemit të muslimanëve. Perëndimorëtduhet t’i kthejnë sytë nga vetë qëndrimet e tyre lidhur me këtë e të pranojnë që në perëndim, vetëm tani vonë, strukturat patriarkale kanë filluar tëshpërbëhen. Tradita islame vërtet që shfaq disa zona ku ka një papajtueshmëri të dukshme lidhur me përcaktimin e qëllimit të gruas ashtu si nëperëndim, dhe muslimanët kanë përpara tyre një rrugë të gjatë për të bërë lidhur me qëndrimet e tyre ndaj gruas. Por padija e fesë – edhe një herë –është të shfaqësh injurancën tënde, si lidhur me fenë, ashtu edhe me përpjekjet historike për barazi të grave në shoqërinë muslimane.

Një lexim i kujdesshëm i teologëve muslimane do të bënte që gruaja perëndimore të mbetej emahnitur nga rregullimet ligjore të nënshkuara përparamëse 1000 vjetësh, për shembull, që u jepningrave të drejtë ligjore për të qenë të ndihmuara në punët e shtëpisë nga burrat. Tre nga katër shkollatjuridike, punët e shtëpisë i konsiderojnë jashtë përfshirjes së përgjegjësive ligjore të gruasë kundrejtburrit të saj. Krahasojeni këtë me sondazhetamerikane që tregojnë se gratë që kanë një punë edhejashtë shtëpisë ende vazhdojnë të kryejnë 80% të punëve shtëpiake. Perëndimorët, në apeline tyreper konformizëm global, shpesh flasin për “progres” dhe për refuzimin e të kaluarës feudale jo shumë të largët, ndërsa janë më pak të prirur përtë nxjerrë në shesh sikletin e tyre mbi hegjemoninë e korporatave dhe implikimet e vërteta njerëzore lidhur me globalizmin.

Ndwrsa misionarët e vlerave perëndimore aq qw pwrpiqen për të gjykuar pse Evropa, zemra e perëndimit, të ketë gjeneruar dy luftëra botërore në tëcilën janë vlarë më shumë civilë se në të gjitha luftërat e mëparshme përgjatë tërë 20 shekujve. Ashtu siç e theksojnë muslimanët, ne na kërkohet që t’i quajmë “luftra botërore”, edhe pse ato realisht janë luftëra perëndimore, që shënjestronin civilë me armë të shkatërrimit në masë në një kohë kurvendet muslimane kanë kaluar tërësisht në paqë mes tyre. Ne muslimanëve nuk na bëjnë përshtypje pretendimet triumfaliste në llogari të perëndimit,porjemi të kënaqur me vlerat në themel të atij qytetërimi. Si një perëndimor, fëmijë i një aktivisti kundërluftës dhe propagandues i të drejtaveqytetare, përqaftimin e Islamit nuk e përjetova si një braktisje tëvlerave të mia, të përfuara pothuajse tërësisht nga tradita progresiste, por si njëafirmim të tyre. Qëatëherë, kam studiuar ligjin islam për 10 vjet me rradhë me dijetarë tradicionalistë, dhe ndërkohë qëdisa veçanti në disa tekstemesjetare më kanë shqetësuar, asnjëherë të përgjithshmet nuk kanë rënëkundërshti me asgjë prej atyre që nëna ime progresiste nga Kaliforniamë ka mësuar. Përkundrazijam mrekulluar se si pjesa më e madhe e shoqërisë perëndimore, ato që i pretendon si idealet më tëlarta të saj, janë tërrënjësura thellë në traditën islame.

Shovinizmi i shfaqur mes ca perëndimorëve në mënyrë tipike shkaktohet nga ekstremizmi islamik. Të pakët janë ata që përpriqen për të dalluar selislami i rrymës kryesore, po aq sa edhe perëndimi, nuk e aprovon aspak ekstremizmin. Ajo që unë kam frikë, është se mund të jetë gjetur ndonjëjustifikim, duke i pajisur këta perëndimorë me një zëvendësues për shprehinë e tyre më të hershme të antisemitizmit. Transformimi nuk ka pse të jetëkaq i vështirë. Arabët, në fund të fundit, janë semitë, dhe mësimet e

profetit arab janë më afër Judaizmit në teologji dhe në legjislaturë sesaKrishterimit. Ne muslimanët në perëndim, ashtu si hebrenjtë para nesh, ndeshemi me të njëjtat probleme qw kanw ndeshur hebrenjtë në të kaluarën:integrim apo izolim, traditë apo reformë duke kontribuar në shoqëri, apo duke u

ekskematizuar nëpër gate dhe duke qënë mizerisht mepërfillës ndajibigjenës personale

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi